

Bujar Idrizi<sup>1</sup>

UDC: 316.7:7.097(560:497.7)

**EFEKTI I SERIALEVE TURKE NË KONTEKSTIN E  
DIPLOMACISË KULTURORE: SHEMBULLI I MAQEDONISË SË  
VERIUT**

**ЭФЕКТОВ НА ТУРСКИТЕ СЕРИИ ВО КОНТЕКСТ НА  
КУЛТУРНАТА ДИПЛОМАТИЈА: ПРИМЕРОТ НА СЕВЕРНА  
МАКЕДОНИЈА**

**THE EFFECT OF TURKISH TV SHOWS IN THE CONTEXT OF  
CULTURAL DIPLOMACY: THE EXAMPLE OF NORTH  
MACEDONIA**

**Abstract**

The concept of the image has an extremely important place at the point of creating the correct perception and positive mental representation in front of the target audiences of the countries.

In North Macedonia, at least two Turkish TV shows have been broadcasted on almost every channel for years without interruption. Some of the TV shows have been broadcasted in Turkish language with Albanian or Macedonian subtitles, but most of them are dubbed. A teaser of the new TV show is given at each season finale. Through this research we have tried to give the answer of cultural changes and trends through the years and the difference in perception about Republic of Türkiye between the generation who has been raised watching these TV shows and the older generation.

**Keywords:** *Turkish TV shows, cultural diplomacy, public diplomacy, Turkish culture*

---

<sup>1</sup> Student postdiplomik në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.

## Koncepti i diplomacisë kulturore dhe zbatimi i saj nga qeveria turke

Diplomacia kulturore i takon sferës së diplomacisë publike e cila si synim ka mbjelljen e vlerave të një grupi të caktuar në grupe të ndryshme etnike apo fetare, pa imponuar aktivitetet e saj dhe duke shfrytëzuar fuqinë e butë. Fuqia e butë e një vendi, përcaktohet nga vlerat politike, kultura dhe politika e jashtme e atij vendi. Ndryshe, diplomacia publike mund të shprehet edhe si shfrytëzimi i aseteve kulturore, ideologjike dhe sociologjike të një vendi me ndihmën e mjeteve të ndryshme për të ndikuar te qytetarët e vendeve të tjera<sup>2</sup>.

Në botën digjitale, aseti më i rëndësishëm i një vendi për zbatimin e diplomacisë kulturore është fuqia mediatike dhe ndikimi në përditshmërinë e grupit të targetuar, nëpërmjet krijimit të trendeve të reja dhe “imponimit” të pikëpamjeve mbi vlerat dhe antivlerat të cilat janë të ndërtuara në atë shoqëri. Duke pasur parasysh faktin se pozita gjeografike e Gadishullit Ballkanik është e rëndësishme dhe tërheqëse për fuqitë e mëdha, duke përfshirë edhe Republikën e Turqisë<sup>3</sup>, shteti turk i ka kushtuar rëndësi të veçantë ndërtimit të një imazhi të mirëfilltë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore si pjesë e diplomacisë publike. Ndër këto aktivitete mund të radhisim:

- Hapjen e qendrave kulturore për mësimin e gjuhës turke;
- Hapjen e universiteteve private të financuara nga Republika e Turqisë<sup>4</sup>;
- Hapjen dhe subvencionimin e bizneseve që proklamojnë kulturën turke, në pikat strategjike të qytetit;
- Krijimin e kushteve të përshtatshme për transmetimin e serialeve turke.

<sup>2</sup> Göksu, O. & Okmen, Y. (2019). Kültürel Diplomasisi Bağlamında Türk Dizilerinin İhracatı ve Kültür Aktarımına Katkısı: ‘Diriliş Ertuğrul’ Örneği.

Shih në: [https://tasam.org/Files/Icerik/File/Kamu\\_Diplomasisinde\\_Yeni\\_Y%C3%B6nelimler\\_\(2\)\\_pdf\\_18aaac77-d41b-4ee7-9d58-6178c992cab3.pdf](https://tasam.org/Files/Icerik/File/Kamu_Diplomasisinde_Yeni_Y%C3%B6nelimler_(2)_pdf_18aaac77-d41b-4ee7-9d58-6178c992cab3.pdf)

<sup>3</sup> Akova, S. (2014). Türk dizilerinin Balkanlar’daki etkileri (Sırbistan, Karadağ ve Bosna Hersek Örnekleme) Kültürlerarası iletişim bağlamında; Türk dizilerinin fahri elçiler olmaları söyleminden hareketle, Türk ve Balkan toplumlarının, kültürel ve tarihi benzerliklerini okumak (Yayımlanmamış Doktora Tezi). Maltepe Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, İstanbul.

<sup>4</sup> Tanyeri Mazıcı, E. & Kodal, T. (2015). Kültürel diplomasi aracılığıyla ülke imajı: Orta Asya Türk cumhuriyetleri perspektifinden bir araştırma. *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, 8 (39), 965-974.

## Kinematografia turke, një Hollywood i ri

Nëse e marrim për bazë sektorin e serialeve nëpër botë, vërejmë se industria e filmit në Turqi ka ndërtuar imazh shumë të rëndësishëm dhe prodhimet e saj kanë arritur të transmetohen në vende të ndryshme të botës.<sup>5</sup> Në këtë aspekt industria e filmit ka kaluar çdo pritshmëri të shikueshmërisë, dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në transmetimin e vlerave dhe historisë së Turqisë. Kjo dëshmohet nga rritja e numrit të turistëve që i vizitojnë vendet e ndryshme ku janë xhiruar serialet e preferuara si dhe në ndërtimin e imazhit të qyteteve turistike, siç janë Stambolli, Mardini, Trabzoni apo Rizeja<sup>6</sup>.

Krahas ndikimit kulturor, industria e filmit ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në hapjen e vendeve të punës<sup>7</sup>. Kështu, falë kërkesës së madhe për transmetimin e serialeve turke në vende të ndryshme të botës, aktualisht në tregun turk janë të pranishme rreth 45 produksione të filmit dhe 150 regjisorë aktivë, nga të cilat vetëm në vitin 2008 kanë qarkulluar të ardhura me vlerë prej 10 milionë dollarësh, shumë e cila në vitin 2018 është rritur në 500 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2023 synon që të arrijë vlerën prej një miliard dollarësh<sup>8</sup>.

### Shembulli i kinematografisë turke në përdorimin e fuqisë së butë

Sipas shkencëtarit amerikan Joseph Nye, “Soft Power” ose *fuqia e butë* është element kryesor i politikës së përditshme demokratike. Për të, “vendosja e preferencave ka tendencë të shoqërohet me asete jomateriale si personaliteti, kultura, vlerat etj., ... (fuqia e butë) është gjithashtu aftësi për të joshur dhe tërhequr”.<sup>9</sup>

Produkti mediatik është metoda më e sofistikuar e përdorimit të fuqisë së butë, ku nëpërmjet krijimit të programeve mediatike, shtetet e

<sup>5</sup> Balaban, A. (2015). The Impacts of Turkish TV Serials Broadcasted in Albania on Albanian and Turkish Relations. *EJSER*, 2, 466-489.

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Medin, B. & Koyuncu, S. (2017). Bir yumuşak güç aracı olarak sinema: Hollywood örneği. *International Journal of Social Sciences and Education Research*. 3. 836-836. 10.24289/ijsser.307385

<sup>8</sup> Marrë nga: <https://www.aa.com.tr/tr/kultur-sanat/abdden-sonra-en-fazla-dizi-ihrac-eden-ulke-turkiye/1641524> Me datë: 6.12.2022.

<sup>9</sup> Nye, S. Joseph. “Public Diplomacy and Soft Power.” (2008). *The Annals of the American Academy of Political and Social Science*.

fuqishme synojnë të jenë të pranishëm në çdo vend ku ata nuk kanë mundësi apo nuk dëshirojnë që të jenë të pranishëm nëpërmjet *fuqisë së fortë*, duke krijuar një strategji që i nxit njerëzit të shikojnë programet televizive që në vete mbartin tregues të kulturës dhe vlerave të vendit zbatues të kësaj fuqie<sup>10</sup>.

Zhvillimi i industrisë mediatike në Republikën e Turqisë, i ka lejuar qeverisë që të zhvillojë një fushatë propagandistike shumë të suksesshme në krijimin e imazhit të dëshiruar për periudhat e ndryshme historike, e në veçanti për periudhën e hershme të popullit turk. Shembull më i mirë janë serialet e prodhuara nga Televizioni Kombëtar Turk (TRT) “Diriliş Ertuğrul<sup>11</sup>” dhe “Payitaht Abdülhamit<sup>12</sup>”, me të cilat qeveria e Turqisë është munduar t’i lidhë ngjarjet historike nga e kaluara me ngjarjet aktuale dhe kështu të jep mesazhin e dëshiruar rreth synimeve të Turqisë.

### **Historiku i transmetimit të serialeve turke në Republikun e Maqedonisë së Veriut dhe ndikimi i tyre në krijimin e imazhit pozitiv për Turqinë**

Prej shumë vitesh, në Maqedoninë e Veriut në televizionet kombëtare ka filluar transmetimi i serialeve dhe filmave të kinematografisë turke, të cilat përveç ndikimit në ndryshimin e skemës mediatike, kanë ndikuar edhe në sfera të ndryshme kulturore.

Transmetimi i serialeve turke në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fillimet e saj i ka që nga viti 2008, kur për herë të parë në Televizionin ERA u transmetua seriali “Acı Hayat (*Jeta e Hidhur*)”. Përveç stafit të aktorëve profesionalë dhe skenarit dramatik, rol të rëndësishëm për pranimin e menjëhershëm nga shtresat e ndryshme të popullatës shqiptare ka luajtur edhe emri artistik i aktorit kryesor, “Mehmet Kosovari”, i cili ngjallte ndjenja kombëtare te shqiptarët, duke u nis nga fakti i lidhjeve familjare me shqiptarët që banojnë në Turqi. Pas përfundimit të serialit “*Jeta e Hidhur*”, filloi të transmetohet seriali “*Lugina e Ujqërve*” edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën arriti që t’i kalojë të gjitha pritshmëritë e shikueshmërisë.

<sup>10</sup> *Türk dizileri dünyada neden bu kadar ilgi gördü?* (2018, 15 Mart). YouTube. Data 29.06.2019 <https://www.youtube.com/watch?v=MKs7HnIfhM8>

<sup>11</sup> *Diriliş Ertuğrul* (Rilindja: Ertugrul) është serial me karakter historik që bazohet në jetën dhe veprën e Ertugrullit, i cili jetoi gjatë shekullit XIII, i cili është i ati i Osmanit, themeluesit të shtetit Osman.

<sup>12</sup> Seriali *Payitah Abdülhamit* është i bazuar në ngjarjet e trembëdhjetë viteve të fundit të udhëheqjes së Sulltanit të 34-të të Perandorisë Osmane, Sulltan Abdul Hamidit.”

Fakti që Televizioni ERA filloi me ritransmetimin e episodeve të kaluara të serialit “*Jeta e Hidhur*” dhe mirëpritja madhështore e aktorëve të serialit “*Lugina e Ujqërve*” në qytetet kryesore të Maqedonisë së Veriut, tregon që serialet turke kishin filluar të familjarizohen me shikuesit në Maqedoni të Veriut dhe ishin pjesë shumë e rëndësishme e përditshmërisë së tyre.

Transmetimi i serialeve turke për herë të parë në Maqedoninë e Veriut filloi në televizionet kombëtare me emetim në gjuhën shqipe, siç janë: TV ERA, ALSAT M, TV SHENJA.

Serialet e para janë transmetuar në gjuhën turke me titra në gjuhën shqipe, por pas interesit të madh, ato filluan edhe me titra në gjuhën maqedonase dhe të transmetohen edhe në kanalet maqedonase, të cilat ngjallën kureshtje të madhe te kjo pjesë e popullatës në mësimin e gjuhës dhe kulturës turke.

Me rritjen e dëshirës për t’u familjarizuar me kulturën turke dhe mësimin e gjuhës, rritje pozitive pati interesimi i madh për të ndjekur kurset, në Qendrën Kulturore Yunus Emre<sup>13</sup>, diploma e së cilës njihet zyrtarisht nga Republika e Turqisë. Kjo ndikoi edhe në krijimin e vendeve të reja të punës si dhe rritjen e mundësive të biznesit ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë.

### **Ndikimi i serialeve turke në orientimin profesional**

Vlen të përmendet që emitimi i serialeve turke nëpër televizionet lokale luajti rol të rëndësishëm tek një numër i konsiderueshëm studentësh që të vijnë studimet në universitete të Turqisë. Në kuadër të këtij hulumtimi, kemi realizuar intervista<sup>14</sup> me gjithsej 15 studentë nga Maqedonia e Veriut që vijnë studimet e tyre në Republikën e Turqisë. Ajo që ka ra në sy është fakti që përsëri informatave të pakta rreth infrastrukturës akademike në Turqi, siç mund të vërehet edhe në tabelat e mëposhtme, arsyeja kryesore që i ka nxitur të studiojnë atje ka qenë përvoja paraprake me serialet turke dhe dëshira për të eksploruar vendet ku janë xhiruar ato seriale.

---

<sup>13</sup> Instituti “Yunus Emre” u themelua në vitin 2009 me iniciativë të qeverisë turke dhe aktualisht ka 66 qendra kulturore në vende të ndryshme të botës. Krahas kurseve të gjuhës turke organizon edhe aktivitetet të ndryshme për promovimin e kulturës dhe artit turk.

<sup>14</sup> Në kuadër të këtij hulumtimi kemi përdorur edhe intervistën si mjet i grumbullimit të të dhënave. Intervistat me studentët janë realizuar gjatë muajit nëntor të vitit 2022 në formën online nëpërmjet pyetësorit.



## Çarshia e Vjetër dhe kultura turke

Krahas ndikimit në edukim, serialet turke dukshëm kanë ndikuar edhe në botëkuptimet kulturore, stilin e veshjes dhe në shtimin e menysë në restorantet në Çarshinë e Vjetër në Shkup.

Duke pasur parasysh se në Çarshinë e Vjetër të Shkupit gjithmonë ka dominuar një ambient i atillë i cili ka pasur disponim miqësor ndaj kulturës turke, rritja e transmetimit të serialeve turke ka ndikuar në informimin më të hollësishëm rreth mundësive komerciale me shtetin e Turqisë, si dhe shndërrimi i tyre në mundësi për të përfituar ekonomikisht nga popullata vendase. Në këtë drejtim, në Çarshinë e Vjetër kohëve të fundit janë hapur butiqe që ndër tjerash frekuentoheshin edhe nga simpatizantë të serialeve turke, në të cilën vërehej tendenca e tyre për të kopjuar aktorët e tyre të preferuar.

Pas rritjes së dyqaneve të veshmbathjes, efekti tjetër i rëndësishëm është vërejtur edhe në rritjen e lokaleve ushqimore, që meny të tyre i kanë pasuruar edhe me ushqimet turke apo edhe dyqane të veçanta për ushqimet turke, siç janë: *Çiğ Köfte*, *Lokma*, *Tantuni*, *Kokoreç*,

*Künefe etj.*, ushqime këto që i takojnë ekskluzivisht kulturës turke e që nuk kanë qenë të pranishme në vendin tonë dhe janë shfaqur vetëm pas fillimit të transmetimit të serialeve turke.


Ndikim tjetër të rëndësishëm në ndryshimin e përditshmërisë ka luajtur edhe importimi i trendeve të reja në shoqërinë tonë, siç është edhe pirja e të ashtuquajturës *nargile (shisha)*. Krahas ndikimit në veshmbathje, ushqime e përditshmëri, ndikim tjetër në Çarshinë e Vjetër është vërejtur edhe ndryshimi i emrave të lokaleve me emrat e vendeve atraktive të vendit turk, p.sh. *Balat, Istanbul, Hürrem etj.*, si dhe lëshimi i muzikës turke në shumicën e vendeve ku frekuentojnë kryesisht të rinjtë që vazhdimisht janë ndjekës të serialeve turke apo programeve të ndryshme televizive.

Si rrjedhojë e transmetimit të serialeve turke, edhe pranisë së tyre nëpër vendbanimet, bëri që operatorët televiziv të shtojnë transmetimin e kanaleve turke dhe kjo të shfrytëzohet si mundësi profitabile në pasurimin e ofertave të ndryshme<sup>15</sup>.


### **Ndikimi i serialeve turke në rritjen e simpatisë për kulturën turke te gjeneratat e reja**

Si pasojë e transmetimit disavjeçar të serialeve turke, gjeneratat e reja të cilat janë rritur duke shikuar ato seriale, kanë mëvetësuar elemente të ndryshme të kulturës turke dhe Republikën e Turqisë e shohin si referencë për ndryshimet kulturore në botën e globalizuar. Gjithashtu mund të themi se është rritur dukshëm simpatia për shtetin turk, ku tash e disa vite po vazhdon trendi i vizitave masive turistike në Republikën e Turqisë, partneriteti tregtar, si dhe preferenca nga ana e studentëve për të studiuar në atë vend. Rezultatet pyetësorit tonë të realizuar me 30 pjesëmarrës pavarësisht bindjeve dhe profilit intelektual, nga zona të ndryshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, tregojnë se te gjeneratat e reja, të cilat janë rritur gjatë viteve kur transmetoheshin serialet turke, është rritur simpatia për kulturën turke në krahasim me gjeneratat më të vjetra.

<sup>15</sup> Si ilustrim mund të përmendim që në operatorët kabllorë lokalë në listën e transmetimit gjenden disa kanale televizive turke, p.sh. *ATV, SHOW TV, KANAL D, STAR TV etj.*







## Conclusion

From what we have presented above by trying to make it clear the importance of soft power and the cultural activities that has effected the population in North Macedonia who regularly follows Turkish TV shows, we can conclude that the Turkish governance has done a well organized cultural diplomacy activity in Balkan Peninsula and especially in North Macedonia through Turkish TV shows.

Based on fact that the new generation has a better opinion about Turkish culture and the daily routin of people is organized from this Tv shows, like what to eat and what to wear, also considering the fact that Türkiye is the most wanted destination for people from North Macedonia for touristic vecations and also for bussines opportunities.

Althought the facts that the perception about Türkiye is in good conditions, we can conclude that Turkish governance and North Macedonia governance has a lot of oppourtunities to colloborate in the future for creating new connections between citizens so they can have a better opinion about each other. I believe that this research is only the begining

of this case and it has a lot of things to look about, but I hope that this will help as an orientation for more detailed researches in the future.

**Recensentë:**

**Dr. Kujtim Kasami**

**Dr. Muhamed Jashari**

**Literatura e konsultuar:**

Akova, S. (2014). *Türk dizilerinin Balkanlar'daki etkileri (Sırbistan, Karadağ ve Bosna Hersek Örnelemi) Kültürlerarası iletişim bağlamında; Türk dizilerinin fahri elçiler olmaları söyleminden hareketle, Türk ve Balkan toplumlarının, kültürel ve tarihi benzerliklerini okumak* (Yayımlanmamış Doktora Tezi). Maltepe Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, İstanbul.

Balaban, A. The Impacts of Turkish TV Serials Broadcasted in Albania on Albanian and Turkish Relations. *EJSER* 2015, 2, 466-489.

Göksu, O. & Okmen, Y. (2019). Kültürel Diplomasisi Bağlamında Türk Dizilerinin İhracatı ve Kültür Aktarımına Katkısı: 'Diriliş Ertuğrul' Örneği. [https://tasam.org/Files/Icerik/File/Kamu\\_Diplomasisinde\\_Yeni\\_Y%C3%B6nelimler\\_\(2\)\\_pdf\\_18aaac77-d41b-4ee7-9d58-6178c992cab3.pdf](https://tasam.org/Files/Icerik/File/Kamu_Diplomasisinde_Yeni_Y%C3%B6nelimler_(2)_pdf_18aaac77-d41b-4ee7-9d58-6178c992cab3.pdf)

Nye, S. J. "Public Diplomacy and Soft Power." (2008). *The Annals of the American Academy of Political and Social Science*. 94-109.

Medin, B. & Koyuncu, S. (2017). Bir yumuşak güç aracı olarak sinema: Hollywood örneği. *International Journal of Social Sciences and Education Research*. 3. 836-836. 10.24289/ijsser.307385.

Tanyeri Mazıcı, E. & Kodal, T. (2015). Kültürel diplomasi aracılığıyla ülke imajı: Orta Asya Türk cumhuriyetleri perspektifinden bir araştırma. *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, 8 (39), 965-974

*Türk dizileri dünyada neden bu kadar ilgi gördü?* (2018, 15 Mart). YouTube. Data 29.06.2019 <https://www.youtube.com/watch?v=MKs7HnIfhM8>